



Republika e Kosovës / Republic of Kosova

Komuna / Municipality

Hani i Elezit



02/3243/2023

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave nr 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Public të OJQ-ve dhe në Rregulloren e Komunës së Hanit të Elezit 01/NR.2821/2022 të datës 31.05.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, Komuna Hani Elezit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve dhe individëve të pranuar sipas thirrjes publike të Komunës

Bazuar në rregulloren e MF nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve neni 8 , paragrafi 3.2 , që pjesë e çdo komisioni vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhen të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim Komuna Hani Elezit fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të sipas thirrjes publike të Komunës së Hanit të Elezit të datës: 20.03.2023 të publikuar nga Komuna.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo ndonjë procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparsi nga OJQ-të që merren me fushën e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe OJQ-ve tjera mund të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësi të:

Pozitat :

- Një përfaqësues/e nga OJQ-të
- Një përfaqësues/e në cilësinë e ekspertit/es

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të angazhuar në Organizata jo-qeveritare aktive që veprojnë në komunën e Hanit të Elezit
- Ekspert të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlidhet në hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe OJQ-ve tjera.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë diplomë univeristare,
- Të kenë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e kulturës, rinisë, sportit dhe OJQ-ve tjera,
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjajshme në administratë shtetërore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- CV
- Letër motivim nga OJQ me të cilën dëshkohet se aplikuesi është i angazhuar apo punësuar në organizatë
- Diploma universitare

Dokumentacionet e kompletuara të dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati përdhësë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00.

Thirrja mbetet e hapur 03 ditë nga data 13.04.2023 deri 18.04.2023 (16:00).

Një komision i themeluar nga Komuna, do t'i vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike, do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues për subvencionimin e OJQ-ve dhe individëve për vitin 2023.

DATA: 13.04.2023
Hani i Elezit

